



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



Në bazë të autorizimeve të dhëna me neni 10 paragrafi 3 të Ligjit nr. 03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, nenin 37.2 nën paragrafi (c), të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe nenin 6 dhe 7 të udhëzimit Administrativ për Zëvendësimin e Anëtarit të Kuvendit Komunal, Nr.01/2017, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, më 16.09.2019, nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **Z. QEMAL KRASNIQI** emërohet anëtar i Kuvendit Komunal në Prizren, nga subjekti politik "Lidhja Demokratike e Kosovës- LDK" duke e zëvendësuar anëtarin e Kuvendit Komunal z. Xhavit Uka.
- II. Obligohet Sekretariati i KQZ-së, që ky vendim t'i komunikohet z. Qemal Krasniqi dhe të ndërmerren veprimet procedurale për zbatimin e tij.

Arsyetim

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të dorëzuara në KQZ më datën 12.09.2019, Nr.1024/2019, për zëvendësimin e anëtarit të Kuvendit Komunal z. Xhavit Uka pas dorëheqjes së tij të parevokueshme nga pozita e anëtarit të Kuvendit të Komunës, për arsye të kandidimit të tij si deputet në Parlamentin e Kosovës .

Andaj, duke u bazuar në deklaratën e pranimit të mandatit të kandidatit të radhës sipas listës së rirenditur, i cili është, z. Qemal Krasniqi nga i njëjti subjekt politik, i gjinisë së njëjtë dhe me numër më të madh të votave, sipas rezultateve të certifikuar të zgjedhjeve lokale të vitit 2017, dhe pas plotësimit të të gjitha kushteve ligjore, KQZ-ja vendosi si në pikën I të këtij vendimi.

- III. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të tij.

Prishtinë, 16.09.2019

Kryetare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve



Valdete Daka